



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:130450

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06277641

**P.nr.109/2024**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtares ligjore Alberitë Bibaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.S.G.nga fshati M., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par.3.2 lidhur me par.2 dhe par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.444/2024 të datës 24.05.2024 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 08.07.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Qazim Kuqi, të dëmtuarit të mitur O.K.së bashku me përfaqësuesin ligjor S.K., të akuzuarin R.K.së bashku me mbrojtësen avokate Albanë Krasniqi - Zogaj sipas detyrës zyrtare, **më 11 korrik 2024, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

## A K T G J Y K I M

I akuzuari **R.K.**i lindur më .... nga fshati M., Komuna e Malishevës, nga i ati S. dhe e ëma K., e gjinisë Zh., i martuar, i ati i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor teknik në SHFMU B.G.i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më parë, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

### SEPSE,

Më 28.03.2024 rreth orës 12:30/h, në fshatin M., Komuna e Malishevës, saktësisht në objektin e SH.F.M.U B.G.me send që mund të shkaktoj lëndim te rëndë trupor, viktimës së ndjeshme të miturit - O.K., i shkakton lëndime të lehta trupore, në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri në cilësi të punëtorit teknik të shkollës së lartshënuar, kishte ndërhyrë për t'i larguar 2 nxënës që ishin kacafytur në mes vete, afër tij afrohet i dëmtuar me qëllim për të pyetur se çfarë po ndodhë, në ato momente i pandehuri tenton ta godasë por i dëmtuari i vendos duart tek fytyra që të mbrohet, e me pas i pandehuri hynë brenda objektit të shkollës dhe merr një bisht fshese (mjet të fortë) dhe me të e godet të dëmtuarin disa herë, me çka të njëjtit i shkakton lëndime trupore si skuqje në pjesën e përparja të të dy kofshëve, të cilat lëndime në bazë të ekspertizës mjeko-ligjore janë kualifikuar si dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshme në shëndet.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.3 nën par. 3.2 lidhur me par. 2 dhe par. 1 nën par. 1. 4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7,17,38,39,40,42,46,47,48,49,55,69,70,79,185 par.3 nën par. 3.2 lidhur me par. 2 dhe par. 1 nën par. 1. 4 të KPRK-së, dhe nenit 241,242, 364,365 të KPP-së, të akuzuarës i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i pandehuri **R.K.**dënohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **PESË (5) MUAJSH**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhë prej dy (2) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Në qoftë se i akuzuar **R.K.**gjatë kohës së verifikimit kryen ndonjë vepër të re penale, do ti llogaritet edhe koha e kaluar në **NDALIM** nga data 28.03.2024 deri më 30.03.2024.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 €, si dhe për shpenzimet mjeko – ligjore në shumën prej 20,00 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari i mitur O.S.K., së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor S.K., nga fshati M., Komuna e Malishevës, lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

## Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 444/2024, të datës 24.05.2024, kundër të akuzuarit R.S.G.nga fshati M., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par. 3.2 lidhur me par.2 dhe par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 08.07.2024. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi. Të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit Qazim Kuqi deklaroi se : nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit gjatë këtij shqyrtimi fillestar pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, prandaj gjykatës i propozoj që të bëjë pranimin e fajësisë si shprehje e lirë e vullnetit dhe të akuzuarit të i shqiptojë një dënim meritor konform ligjit, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të precizuara sikurse në aktakuzë, në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së si dhe një herë të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit O.K., S.K. deklaroi se: nuk kërkojë që të dënohet i akuzuari dhe nuk kërkon kompensim dëmi pasi që jemi pajtuar me familje, si dhe me të pandehurin asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë problem.

I dëmtuari i mitur O.K.deklaroi se: nuk kërkojë që të dënohet i akuzuari dhe nuk kërkojë kompensim dëmi dhe nuk kemi pasur më asnjëherë probleme me askënd.

Mbrojtësja e të pandehurit R.G., avokat Albanë Krasniqi - Zogaj, deklaroi se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë së të mbrojturit tim, kjo për faktin se i njëjti është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtëse, ka kuptuar benefitet e pranimit të fajësisë, familja e të pandehurit me të dëmtuarin janë pajtuar dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit kërkojë nga gjykata të këtë vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese së të pandehurit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së.

I akuzuari R.G., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem, të njëjtën e pranoj në mënyrë vullnetare, ky është rasti im i parë që kam kryer vepër penale, kërkojë nga gjykata që të më dënojë sa më pak, pendohem për veprën penale për të cilën ngarkohem, i kërkojë falje familjes së të dëmtuarit, jemi pajtuar me të miturin dhe babin e tij, nuk kemi pasur asnjëherë probleme dhe kërkojë nga gjykata që të më dënojë sa më pak mundësisht me dënim me kusht.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti mjekësor QKMF- M. për O.K.nr. 7306 i datës 28.03.2024; foto dokumentacion; një (1) CD me video incizime; raporti i oficerit L. E. – B. ID#... i datës 28.03.2024; procesverbal i marrjes në pyetje për R.K.nr.... i datës 28.03.2024; raporti i oficerit ID ... i datës 28.03.2024; procesverbal i marrjes në pyetje për F.K. nr.... i datës 28.03.2024; procesverbal i marrjes në pyetje për O.K.nr.... i datës 08.04.2024; raporti fillestar i incidentit nr.... i datës 28.02.2024; procesverbal i marrjes në pyetje për O.K.nr..... i datës 28.03.2024 si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i kërkoi falje të dëmtuarit, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, i dëmtuari i mitur së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor nuk kanë kërkuar që të dënohet i akuzuari, nuk kanë kërkuar kompensim dëmi, të njëjtit janë pajtuar në mes vete. Të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5)

muajsh, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.08/L-109.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim të kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364,365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 109/2024, më 11 korrik 2024**

**Zyrtarja Ligjore**  
**Alberitë BIBAJ**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Njazi MORINA**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.